



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Department Slobodnih Profesija -
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPL.nr.06/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P.nr.04/23, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Burbuqe Spahija-Kërveshi, pala ankuese dhe Përmbarduesi Privat, me datë 04.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-06/2023 i datës 07.02.2023 dhe ankesa e palës ankuese e datës 31.01.2023 dhe e plotësuar me datën 03.02.2023, si të pabazuara.

II. Përmbarduesi privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore, nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P.nr.04/23.

A r s y e t i m

Me datën 31.01.2023 pala ankuese ka parashtruar ankesë ndaj përmbarduesit privat, të cilën e ka plotësuar me datën 03.02.2023, me pretendimin se në lëndën P.nr.04/23, përmbarduesi privat ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, kur i njëjti ka lëshuar urdhër dhe përpiluar propozimin për përmbardim, që nuk bie në kompetencën e organit përmbardues, pasi janë caktuar me dispozitat e nenit 341 par.1 LPP-së.

Pala ankuese pas pranimit të propozimit e ka bërë pagesën direkt në zyre të kreditorit dhe e ka njoftuar përmbaruesin privat se e ka përmbushur obligimin.

Në vazhdim pala ankuese ka theksuar se pas pagesës së obligimit, nga përmbaruesi ka marrë një fletushkë të shkruar me dorë me numër të llogarisë bankare të përmbaruesit dhe shumën e kërkuar prej 59 euro në emër të shpenzimeve procedurale. Me datën 13.01.2023, debitori ka paguar shumën prej 35.40 euro dhe i është kërkuar përmbaruesit që të mos bëhet konkluzioni duke e konsideruar të përmbyllur këtë procedurë. Sipas palës ankuese me datën 26.01.2023, përmbaruesi ka tërhequr nga llogaria e debitorit shumën prej 141.60 euro. Pala ankuese konsideron që mos lëshimi i faturave nga ana e përmbaruesit është shkelje, pasi është obligim i operatorit ekonomik dhe faturat janë të domosdoshme për ATK-në lidhur me llogaritjen e shpenzimeve dhe se përmbaruesi ka lëshuar vetëm një faturë me nr.00029 për konkluzionin mbyllës në vlerë prej 17.70 euro dhe pasyrën e shpenzimeve që bie ndesh me të gjitha llogaritjet dhe përshkrimin në konkluzionin përmbyllës. Gjithashtu në ankesë pala ankuese pretendon se e ka ngarkuar palën debitore me tarifën e efikasitetit të lëndës.

Pala ankuese pretendon se ka shkelë ligjin, prestigjin e përmbaruesit dhe kodin e etikës profesionale.

I ka propozuar komisionit që ndaj përmbaruesit të ndërmerren masa ligjore për shkeljet e pretenduara.

Me datën 07.02.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, në deklaratën e tij ka theksuar se propozimi në këtë rast është parashtruar nga kreditori dhe propozimi është përpiluar nga vet kreditori, gjë që shihet nga vula dhe organi përmbarues të cilit i është drejtuar kreditori. Debitori e ka kryer obligimin tek kreditori dhe përmbaruesi e ka njoftuar debitorin që shpenzimet në këtë fazë janë 59 euro, ku janë përfshirë 41.30 si taksë e administrimit dhe 17.70 euro për konkluzionin përfundimtar.

Sa i përket pretendimit të pasqyrës si fletushkë për pagesë të shumës prej 59.00 euro, përmbaruesi ka theksuar se i njëjti e ka pranuar vetëm shumën prej 35.40 euro dhe pagesa ka ardhur në llogari të përmbaruesit vetëm me një përshkrim pagese për lëndën P.nr.04/23 dhe pagesa është kryer nga [redacted] e jo nga [redacted] që është edhe debitori dhe se përmbaruesi e ka pasur të vështirë të evidentoj këtë pagesë.

Mbi këtë bazë duke parë që debitori nuk e ka kryer pagesën, përmbaruesi e ka bërë bllokimin e llogarive dhe ka inkasuar shumën prej 141.60 euro.

Sa i përket pasqyrës së shpenzimeve, përmbaruesi privat ka shtuar se kjo çështje është e rregulluar me nenin 353 të LPP-së, ku qartë sqarohet se kur është i obliguar përmbaruesi ta lëshoj pasqyrën e shpenzimeve dhe kjo pasi të përfundoj procedurën.

Përmbaruesi me e-mailin e datës 27.01.2023 e ka njoftuar debitorin se duke mos pasur njohuri për pagesën prej 35.40 euro, ka bërë bllokimin, por nga inkasimi prej 141.60 euro ka ndalur vetëm shumën prej 23.60 euro, për të plotësuar totalin prej 59.00 eurosh, që ka kërkuar që në fillim nga debitori, ndërsa shumën tjetër ia ka kthyer debitorit.

I ka propozuar komisionit t'a shpallë jo përgjegjës përmbaruesin privat dhe që të refuzohet ankesa e palës ankuese.

Në seancën dëgjimore palët kanë mbetur në tërësi si në kërkesat e tyre të mëhershme, ashtuqë pala ankuese i ka propozuar komisionit që ndaj përmbaruesit të ndërmerren masa edhe sa i përket sjelljeve të stafit të përmbaruesit, ndërsa sa i përket shumës së inkasuar në fund nga përmbaruesi është shuma prej 59.00 eurosh.

Përmbaruesi privat nuk e ka mohuar faktin se i njejtë e ka bërë bllokimin e llogarive duke mos pasur njohuri për pagesën e bërë nga debitori prej 35.40 euro. Por ka theksuar poashtu se edhe pse ka bërë bllokimin e llogarive vetëm diferenca për të arritur shumën prej 59.00 eurosh, i ka ndalur, ndërsa pjesën tjetër e ka kthyer tek debitori. Sa i përket pasqyrës së shpenzimeve, përmbaruesi ka theksuar se arësyetimin e ka dhënë edhe në përgjigje dhe e njejtë është lëshuar në përfundim të procedurës përmbarimore.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së.

Këtë konstatim komisioni e bazon në faktin se përmbaruesi ka vepruar duke u bazuar në shkresat e lëndës ku shihet që totali i shpenzimeve procedurale të inkasuara është vetëm shuma prej 59.00 eurosh, pasi diferencën e inkasuar duke mos ditur pagesën e bërë në shumën prej 35.40 eurosh nga pala e tretë në emër të kësaj lënde e jo direkt nga debitori dhe diferencën e tepricës së inkasimit ia ka kthyer tek debitori, ku në fund edhe është lëshuar pasqyra e shpenzimeve me detajet dhe shpenzimet e paguara nga debitori, se janë vetëm ato të administrimit dhe përfundimit të rastit, ndërsa tarifën e efikasitetit e ka llogaritur për kreditorin.

Komisioni ka trajtuar të gjitha provat dhe deklaratimet e palëve dhe bazuar në ato vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.06/2023 datë 04.05.2023,



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqurka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.